

# Hyrje

*Ky Doracak për Sundimin e Ligjit parashihet të jetë një burim i dobishëm i informatave për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ai përmban listën e të gjitha institucioneve kryesore vendore dhe ndërkombëtare për sundimin e ligjit në Kosovë bashkë me mandatet dhe rolet e ndryshme të tyre dhe të dhënat për kontaktim. Shpresojmë se ai do të kontribuojë shumë për t'i kuptuar dhe për rëndësinë e këtyre institucioneve në Kosovë.*

# Përmbajtja

---

EULEX Kosovo	03
Policia e Kosovës	03
Inspektorati i Policisë së Kosovës	04
Shërbimi Korrektues i Kosovës	04
Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore	05
Divizioni për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave	06
Dogana e Kosovës	07
Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë	08
Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit	09
Këshilli Gjqësor i Kosovës	09
Këshilli Danez për Refugjatë (DRC)	10
Agjencia Kosovare e Pronës	11
Komisioni i Pavarur për Media	11
Këshilli i Medieve të Shtypit të Kosovës	12
Qendra për ndihmë juridike dhe zhvillim rajonal (CLARD)	13
Fondi për të Drejtën Humanitare	13
NORMA	14
Komisioni për ndihmë juridike i Kosovës	14
Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	15
PDC/K - Programi për të Drejtat Civile /Kosovë	15
Zyra Ndërlidhëse e Gjykatës	16

## **EULEX Kosovo**

### ***Kontakti:***

Rr. Muharrem Fejza, (ish-Farmedi)

P.O. Box: 268,10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +(381) 38 222 010 2000, Fax: +(381) 38 222 010 6333

E-mail: info@eulex-kosovo.eu

### ***Misioni:***

EULEX-i është mision i integruar i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit që funksionon në fushën e drejtësisë, të policisë dhe të doganës. Misioni do t'ju ndihmojë autoriteteve të Kosovës, autoriteteve gjyqësore dhe agjencive për zbatimin e ligjit që të arrijnë përparim drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies. Do ta zhvillojë dhe forcojë edhe më tej një sistem të pavarur dhe shumetnik të drejtësisë si dhe një polici e shërbim doganor shumetnik, duke u siguruar që këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrja politike dhe t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane.

### ***Shërbimet:***

Misioni, në bashkëpunim të plotë me Programet për Asistencë të Komisionit Evropian, do ta zbatojë mandatin e tij përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit. Misioni i mban disa përgjegjësi ekzekutive në fushat siç janë krimi i organizuar, krimet e luftës dhe krimet e rënda financiare. Personeli i drejtësisë i EULEX-it është aktiv në gjykatat e të gjitha shkallëve në Kosovë.

Më shumë se 1,500 policë të Policisë së EULEX-it janë të vendosur në mbarë Kosovën. Zyrtarët e doganës së EULEX-it. Dogana e EULEX-it ka 6 ekipe lëvizëse të cilat lëvizin në mbarë Kosovën për t'i monitoruar, mentoruar dhe këshilluar kolegët e tyre vendorë. Janë të pranishëm 24-orë në portat 1 dhe 31.

---

## **Policia e Kosovës**

### ***Kontakti:***

Rr. Luan Haradinaj, p.n. Prishtinë, Kosovë

044 192, 038 092, 038 550 999

info@kosovopolice.com

### ***Shërbimet:***

Mbrojtja e jetës dhe e pronës. Ruajtja e rendit publik, parandalimi dhe hetimi i krimeve, mbrojtja e lirisë dhe e të drejtave të njeriut, trajtimi i barabartë për të gjithë, pa dallime race, ngjyre, feje, gjinie apo moshe.

### ***Misioni:***

Zbatimi profesional dhe efektiv i sundimit të ligjit në Kosovë

---

## **Inspektorati i Policisë së Kosovës**

### ***Kontakti:***

Rr. Lidhja e Pejës, p.n, Fushë Kosovë, Kosovë

+381 38 552 176

info.ipk@ks-gov.net

### ***Misioni:***

Misioni i Inspektoratit të Policisë së Kosovës është mbikëqyrja e mënyrës së kryerjes së detyrave nga Policia e Kosovës, për të siguruar një mënyrë profesionale dhe efektive të zbatimit të ligjit në Kosovë

### ***Shërbimet:***

Inspektorët kanë autoritet të hyjnë nëpër stacione dhe departamente policore dhe t'i inspektojnë ato, të intervistojnë policët pavarësisht gradës së tyre, të mbledhin të dhëna lidhur me përmbushjen e detyrave të punës, të bëjnë hetime mbi ankesat disiplinore dhe, nëse është e nevojshme, të konfiskojnë dokumentacione policore.

---

## **Shërbimi Korrektues i Kosovës**

### ***Kontakti:***

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Rr. "Perandori Dioklecian", 10 000 Prishtinë

Tel: 038/200-18-340

### ***Misioni:***

Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e tjerë nga sistemi i drejtësisë penale dhe në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë, ka për qëllim rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve, duke i respektuar të drejtat e tyre themelore pa dallim të racës, gjuhës apo

fesë së tyre, dhe ofron një mjedis të sigurt për personelin, të burgosurit dhe shoqërinë.

### **Shërbimet:**

ShKK është përgjegjës për menaxhimin e të burgosurve, të arrestuarve dhe të miturve në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë, me konventat evropiane dhe me rregulloret e tjera të nxjerra nga institucione përkatëse. ShKK është përgjegjës për menaxhimin e institucioneve të niveleve të ndryshme të sigurisë dhe mbikëqyrjes së personave nën përkujdesjen e ShKK-së.

---

## **Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore**

### **Kontakti:**

Ndërtesa e ZPZhML  
Afër QKUK-së, Rruga drejt Shkupit  
Rr. Bulevardi i Dëshmorëve  
11000, Prishtinë, Kosovë

### **Mandati:**

Përcaktimi dhe zgjidhja e fatit të personave të zhdukur nga konflikti i viteve 1998-1999, dhe si pasojë e tij:

*Hulumtimi i vendeve të dyshuara të jenë varreza dhe zhvarrimi nga to  
Kryerja e autopsive të mbetjeve mortore të paidentifikuara në mënyrë që të përcaktohet shkaku i vdekjes dhe identifikimi përmes përdorimit të analizave antropologjike, antropometrike dhe atyre të ADN-së*

*Bashkërendimi i veprimeve dhe shkëmbimi i informatave me organet e Qeverisë dhe grupet e shoqërisë civile*

*Informimi i palëve me interes rreth progresit të hetimeve dhe kthimi me kohë dhe me respekt i mbetjeve mortore të identifikuara tek familjet e tyre*

*Mbajtja e të dhënave dhe statistikave të azhurnuara lidhur me personat e zhdukur në Kosovë.*

Sigurimi i një sistemi mjekoligjor në Kosovë sipas standardeve evropiane, përfshirë fushat në vijim si dhe të tjera:

*Ekzaminimet mjekësore të viktimave të keqtrajtimit seksual/fizike*  
*Autopsitë në raste të vdekjeve jo-natyrore të dyshimta*  
*Rastet e praktikave jo të duhura mjekësore*  
*Analizat toksikologjike*  
*Analizat histo-patologjike*  
*Analizat mjekoligjore të vendngjarjeve të krimeve dhe vdekjeve*  
*Dëshmi të ekspertëve në gjykata*

### **Misioni:**

Zyra e ekzaminimeve mjekësore të ZPZhML/EULEX i ofron Kosovës cilësinë më të lartë të shërbimeve të mjekësisë ligjore me kohë, duke i siguruar sistemit të drejtësisë një përsosmëri dhe përkushtim përmes integritetit të specialistëve, teknologjisë dhe bartjes së njohurive, përvojës dhe ekspertizës. Veprimtaria e ZPZhML/EULEX mbi personat e zhdukur i kontribuon drejtësisë, mirëkuptimit, kërkimit të së vërtetës dhe rindërtimit të së kaluarës historike përmes zbatimit të shkencës së mjekësisë ligjore, përmes përcaktimit të vendndodhjes dhe identifikimit efikas dhe efektiv të personave të zhdukur në mënyrë që ata t'u kthehen familjeve të tyre.

---

## **Divizioni për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave**

### **Kontakti:**

Prishtinë	044 278 738
Graçanicë	044 425 477
Gjilan	044 310 467
Kamenicë	044 310 467
Viti	044 310 467
Ferizaj	044 161 138
Prizren	044 310 468
Malishevë	044 418 657
Suharekë	044 425 480
Gjakovë	044 418 668
Pejë	044 348 164
Istog	044 352 934
Deçan	044 425 469
Mitrovicë	044 310 466

dhe 063 848 79 91

**[www.md-ks.org](http://www.md-ks.org)**

Rruga "Perandori Dioklecian", 10 000, Prishtinë.

### **Shërbimet:**

Divizioni për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave, të gjitha viktimave të krimit u ofron këshillime ligjore, përfaqësuesin e autorizuar pa pagesë, përkthyesin pa pagesë, shërbimet e strehimit, shërbimet mjekësore, veshmbathje, ushqim dhe shërbime të tjera, duke iu përgjigjur gjithmonë nevojave të viktimave, nga fillimi i procedurave prokuroriale e gjyqësore deri në përfundim të çështjes gjyqësore. Një pjesë e programit të Divizionit për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave konsiston në parandalimin e krimit, nëpërmjet ngritjes së vetëdijes për të drejtat e viktimave, përfshirë edukimin e komuniteteve në zona rurale.

### **Mandati:**

Mandati i Divizionit për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave është që viktimave të krimit, viktimave të dhunës fizike dhe psikike t'u ofrojë qasje më të lehtë në sistemin e drejtësisë para, gjatë dhe pas procedurës gjyqësore, me fokus të veçantë viktimave të dhunës në familje, keqtrajttimeve seksuale, trafikimit me qenie njerëzore, keqtrajttimeve të fëmijëve, tentim vetëvrasjeve, etj.

Vërejtje: Linja ndihmëse 044 080 90 është linjë e anti-trafikimit që shërben VETËM për rastet e trafikimit me qenie njerëzore.

---

## **Dogana e Kosovës**

### **Kontakti:**

Dogana e Kosovës, Bulevardi Bill Clinton p.n. Prishtinë, Kosovë

Tel. 038 540 350, Fax. 038 540 836

Email: [hq@dogana-ks.org](mailto:hq@dogana-ks.org)

Thërrisni në këtë numër për të raportuar korrupsion apo kontrabandën:  
038 500 095

### **Misioni:**

Shërbimi Doganor ka një mision të gjerë duke filluar me mbrojtjen e shtetit, ekonomisë dhe të qytetarëve. Prandaj, misioni i Shërbimit Doganor ndahet në dy kategori kryesore: Kontributi për çështjet ekonomike, Kontributi për siguri.

### ***Shërbimet e ofruara:***

Grumbullimin e të hyrave si: të hyrave doganore, tatimin mbi vlerën e shtuar; akcizën për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Kontrollon importin dhe eksportin; mbron ekonominë; mbron markat tregtare dhe të tjera.

Statistikat për tregti

Luftimi i veprimtarive të kundërligjshme

Prania e shtuar e forcave të sigurisë në kalimet kufitare për: luftimin e krimit në kufi; luftimin e trafikimit të drogës, etj.

Mbrojtja e popullatës dhe ambientit, parandalimi i kontrabandës së armëve dhe mjeteve shpërthyes

---

## **Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë**

### ***Kontakti:***

Zyra qendrore në Prishtinë

Adresa: Rr. Agim Ramadani, p.n.

Tel: +381 (0) 38 501 401, 545 303

Fax: +381 (0) 38 545 302

Email: [ombudsperson@ombudspersonkosovo.org](mailto:ombudsperson@ombudspersonkosovo.org)

### ***Shërbimet e ofruara:***

Nëse hetimet tona vërtetojnë shkelje të drejtave të njeriut, atëherë përfaqësuesit e institucionit të Ombudspersonit mund të kërkojnë mënyra të trajtimit të atij rasti përmes burimeve të ndryshme. Institucioni i Ombudspersonit, për shembull, mund të ndërmjetësojë në mes të palëve (paditësve) dhe autoriteteve lokale, i rekomandon veprime autoriteteve lokale, publikon raporte publike, apo ngrit brengat e tyre përmes mediave.

Në rastet kur një qytetar i Kosovës parashtron një ankesë kundër një autoriteti publik jashtë Kosovës ky institucion mund të ofrojë "shërbime në dobi të palës" në formë të këshillimit apo edhe mbështetje tjetër. Ne, po ashtu, mund ta njoftojmë me rastin edhe Ombudspersonin apo institucionin tjetër përkatës në vendin ku shqyrtohet ky rast.

### ***Misioni***

Ne pranojmë dhe hetojmë ankesa nga çdonjëri në Kosovë i cili beson se të drejtat e tij janë shkelur nga një autoritet publik në Kosovë.

Të gjitha shërbimet ofrohen pa pagesë.

---



## Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit

### *Kontakti:*

Rr.“Bajram Kelmendi”, No. 31, Prishtinë, Kosovë  
00 381 (0) 38 248 563/5  
info@akk-ks.org

Na informoni për korrupsion:  
044 082 82

### *Misioni:*

Qëllimi dhe puna e Agjencisë përqendrohet në zbulimin dhe hetimin e rasteve të korrupsionit, përpjekje për ta parandaluar dhe luftuar dukurinë e korrupsionit, të ndihmojë në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë në Kosovë bazuar në sundim të ligjit.

### *Shërbimet e ofruara:*

Njoftimi i Prokurorit Publik të Kosovës me të dhëna rreth shkeljeve të mundshme që lidhen me korrupsion; ndërmarrja e procedurave të mëtejme dhe kryerja e hetimeve administrative që lidhen me korrupsionin e pohuar në rastet për të cilat nuk kanë nisur procedurat penale;

Mbikëqyrje dhe analizojë të dhënat statistikore lidhur me korrupsionin në Kosovë;

Paralajmërimi i autoriteteve të Kosovës për përgjegjësitë e tyre që dalin nga aktet ndërkombëtare dhe ofron rekomandime për ti zbatuar ato;

Këshillim gjatë përgatitjes së kodit të etikës në sektorët publik dhe privat;

Ofrimi i qartësisë lidhur me papajtueshmërinë, konfliktin e interesit, dhuratave dhe çështjeve tjera që lidhen me korrupsion;

---

## Këshilli Gjyqësor i Kosovës

### *Kontakti:*

Rr. Oborri i Rilindjes, Kontejneri No. 03  
Tel 038 234 630 / 113  
k.gjyqesor.ks@gmail.co

### ***Shërbimet e ofruara:***

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është organi më i lartë në Sistemin Gjyqësor të Kosovës. KGJK është një institucion i ri i themeluar, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e tërë Sistemit Gjyqësor.

### ***Misioni:***

KGJK vepron në drejtim të mbrojtjes së Sistemit Gjyqësor dhe që ai të jetë institucion profesional, i pavarur, i paanshëm, i integruar, i drejtë dhe efikas. KGJK është organ kompetent dhe përgjegjës për caktimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe porotës, masa disiplinore kundër gjyqtarëve, prokurorëve dhe porotës atëherë kur të bëhet ndonjë shkelje si dhe në lidhje me zhvillimin e tyre profesional.

---

## **Këshilli Danez për Refugjatë (DRC)**

### ***Kontakti:***

Mark Isaku 30, Pristina - Kosovo

Telefoni +381 (0)38 243 793/4 & +381 (0)38 245 481

FAX: +381 (0)38 243 796

E-mail: [representative@drc-kosovo.org](mailto:representative@drc-kosovo.org)

### ***Shërbimet:***

Në fillim asistenca e realizuar nga DRC është përqendruar në ndihma emergjente, të cilat më pas u zgjeruan në mbështetje logjistike, transport, strehim dhe aktivitete të rindërtimit, aktivitete për gjenerimin e të hyrave dhe rehabilitim social për personat e zhvendosur, refugjatët dhe popullatën e rrezikuar. DRC ka rehabilituar rreth 5000 shtëpi gjatë këtyre viteve të kaluara në rajonin e Kosovës Veriore dhe Kosovës Perëndimore.

### ***Mandati:***

Që nga viti 2003, DRC është fokusuar vazhdimisht në kthimin e minoriteteve në Kosovë, një program me prioritet i cili është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me DRC Serbia & Mali i Zi. Që atëherë, ky program që kishte të bënte me kthimin, është plotësuar me projekte shtesë që synonin zhvillimin ekonomik, fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe aspektet psiko-sociale të shërbimeve shëndetësore mendore që i ofron në Kosovë. DRC

është gjithashtu e angazhuar në kthimin e obligueshëm nga Evropa Perëndimore. DRC mbetet anëtare e Grupit të OJQ-ve për Koordinimin e Kthimit, si dhe anëtare Bordit Konsultative për Platformën Pro-Paqes, asociacion ky i OJQ-ve vendore që kanë për mandat ndërtimin e paqes.

---

## **Agjencia Kosovare e Pronës**

### ***Kontakti:***

Selia e AKP, Nazim Gafurri 31, Prishtine, Kosova  
Telefoni: : +381 (0)38 249-936, +381 (0)38 249-918  
Telefax: +381 (0)38 2490-919  
mailbox@kpaonline.org

### ***Shërbimet:***

AKP-ja ka mandatin të pranojë, regjistrojë, dhe përmes KKKP-së të zgjidhë kërkesat të cilat janë si pasojë e konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Vendimet e marra nga KKKP-ja mund të ankimohen vetëm para Gjykatës Supreme të Kosovës.

AKP-ja mirëpret dhe inkurajon bashkëpunimin nga të gjithë që ky mandat i cili i është besuar AKP-së, të mund dhe meriton të zbatohet me sukses.

---

## **Komisioni i Pavarur për Media**

### ***Kontakti:***

rr.Gazmend Zajmi , Nr.1 / Prishtina, Kosova  
tel 038/245-031  
fax 038/245-034  
e-mail: info@imc-ko.org  
www.kpm-ks.org  
www.imc-ko.org

### ***Mandati:***

KPM synon të PROMOVOJË zhvillimin e një tregu të suksesshëm mediatik që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës;

TË INKURAJOJË profesionalizmin e gazetarëve, menaxherëve dhe pronarëve të medieve;

TË MBROJË: lirinë e shprehjes, diversitetin e mendimeve, qasjen në informacion për gazetarët dhe publikun, si dhe interesat e shfrytëzuesve dhe operatorëve të medieve ashtu siç e parasheh ligji.

### ***Shërbimet:***

Komisioni është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës përgjegjës për menaxhimin, rregullimin dhe caktimin e resurseve të spektrit të frekuencave të transmetimit dhe për dhënien e licencave dhe mbledhjen e taksave për shfrytëzimin e frekuencave transmetuese

---

## **Këshilli i Medieve të Shtypit të Kosovës**

### ***Kontakti:***

Këshilli i Mediave të Shtypit të Kosovës  
Adresa: rruga "Hajdar Dushi" nr. 7, Prishtina  
Tel. 044 291 810  
Email: [presscouncil.kosovo@gmail.com](mailto:presscouncil.kosovo@gmail.com)

### ***Shërbimet:***

Të na shkruani kurdo herë që konsideroni se një gazetë apo revistë në Kosovë, që është pjesë e Këshillit tonë, i ka shkelur parimet e Kodit, ka ofenduar apo shpifur, ka nxitur urrejtje apo ka mohuar të drejtën për një reagim publik.

### ***Mandati:***

Parimet mbi të cilat bazohet Këshilli i Medieve të Shtypit janë: liria e fjalës, e drejta e qytetarëve që të jenë të informuar në mënyrë të plotë dhe me kohë, si dhe respektimi i Kodit të Etikës së Gazetarisë. Nuk ka për qëllim që t'i zëvendësojë gjykatat e Kosovës, por ka vullnetin që përmes një forumi të besueshëm për shtypin dhe lexuesit si një organ i paanshëm, të sjellim ide dhe njohuri të reja për gazetarë në lëminë e etikës së profesionit të tyre përkatës.

Kosova e pasluftës, krahas nevojës për ndërtime fizike dhe problemeve në këtë lëmi ka edhe shumë probleme të tjera. Kosova tani po pasuron mendjen dhe shpirtin e saj me vlerat kryesore të demokracisë. Dhe mediet e pavarura mbesin synimi ynë i përhershëm si në prej shtyllave më të rëndësishme të

demokracisë në shoqëri.

---

## **Qendra për ndihmë juridike dhe zhvillim rajonal (CLARD)**

### ***Kontakti:***

Rr. Luan Haradinaj 9A/1 Prishtinë

+381 38 228 372

[www.clardkosovo.org](http://www.clardkosovo.org)

### ***Shërbimet:***

CLARD është OJQ e themeluar nga individ me kualifikime të ndryshme profesionale dhe me prejardhje të ndryshme etnike të cilët kanë një përvojë pune mbi 5 vite në programe dhe projekte të ndryshme në kuadër të OJQ-vë ndërkombëtare, ku edhe kishin detyra të ndryshme në dhënien e kontributit tyre në zbatimin e këtyre programeve dhe projekteve.

### ***Misioni:***

Organizata është themeluar me qëllim të dhënies së kontributit në promovimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, e në veçanti për t'iu ndihmuar personave me nevoja të veçanta të kenë qasje me të mirë në drejtësi, në forcimin e sundimit të ligjit dhe në nxitjen e përfshirjes në rrjedhat shoqërore dhe ekonomike të segmenteve të marginalizuara të popullatës drejt arritjes së një të ardhmeje të realizueshme dhe standardeve Evropiane të zhvillimit dhe mirëqenies.

## **Fondi për të Drejtën Humanitare**

### ***Kontakti:***

Adresa: Rr. Eqrem Çabej, 7a, Prishtinë

e-mail: [office.ks@hlc-kosovo.org](mailto:office.ks@hlc-kosovo.org);

Tel/Fax: 038 243 488; 038 243 490

Web: [www.hlc-rdc.org](http://www.hlc-rdc.org)

### ***Shërbimet:***

Monitorimi i Gjykimeve për krime lufte dhe vepra penale etnikisht të motivuara.

Promovimi i mbrojtjes së të drejtave të pakicave, hulumtimi dhe dokumentimi i krimeve të luftës.

### ***Misioni:***

Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë ndihmon shoqërinë Kosovare në vendosjen e sundimit të ligjit, integrimin pakicave dhe ballafaqimin me të kaluarën.

---

## **NORMA**

### ***Kontakti:***

Adresa: Rr. Sylejman Vokshi, 7/12, Prishtinë

Email: shnorma@hotmail.com ; shoqatanorma@yahoo.com

Tel +381 (0)38 249 778; +377 (0)44 126 428;

+386 (0)49 126 428;

### ***Shërbimet:***

Dhënia e ndihmës juridike grave; mbajtja e seminareve për grupet e femrave në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me gratë, duke përfshirë dhunën me motive gjinore; përfaqësimi i grave në gjykatë; ndihma në trajnimet për shkrim dhe lexim për gratë në komunitete si dhe trajnimi në nivel komunal mbi çështjet ligjore, duke përfshirë edhe zbatimin e Konventës mbi ndalimin e çdo forme të diskriminimit ndaj grave

---

## **Komisioni për ndihmë juridike i Kosovës**

### ***Kontakti:***

Rr. Zenel Salihu 30, Prishtinë, Kosovë

+ 381 (0) 38 200 18 224

<http://www.knj-ks.org>

### ***Shërbimet:***

Në Kosovë ekzistojnë 5 Zyra rajonale për ndihmë juridike, të cilat japin ndihmë juridike në fushat e ndryshme të këtij lëmi si në atë penale, civile dhe administrative.

### ***Misioni:***

Dhënia e ndihmës juridike gjithë atyre qytetarëve të Kosovës me vështirësi ekonomike, të cilët i plotësojnë kriteret në baze të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/36 mbi ndihmën juridike, me theks të veçantë grupet e ndjeshme.

## Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

### *Të dhënat për kontakt:*

C-2 II/8 Rruga "Hajdar Dushi"  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Numri i telefonit: +381 (0) 38 245 850  
E-Mail: info@womensnetwork.org

### *Shërbimet:*

Misioni i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGKK) është t'i mbështesë, mbrojë dhe përkrahë të drejtat dhe interesat e grave dhe të vajzave anembanë Kosovës, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimimit, orientimi seksual dhe aftësia e tyre. RrGKK e realizon misionin përmes këmbimit të përvojës dhe të informatave, partneritetit dhe rrjetëzimit, kërkimit, avokimit dhe shërbimit.

---

## PDC/K - Programi për të Drejtat Civile /Kosovë

Rruga "Mbretëresha Teutë", Ndërtesa e OJQ-ve nr#2, Mitrovicë  
044 118 854, 028 539 458  
crp.mi@crpkosovo.org

### *Shërbimet:*

Regjistrimi civil si banor i zakonshëm i Kosovës, përfshirë regjistrimin e gjendjes civile duke u përqendruar në mënyrë të posaçme në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian.

Kontestet e të drejtave pronësore dhe legalizimi i gjendjes pronësore (pronat komerciale, bujqësore dhe pronat e tjera private), procedurat e trashëgimit. Rikthimi i të gjitha llojeve të dokumenteve që janë thelbësore për qasje në të drejtat dhe obligimet individuale civile.

Të drejtat pensionale, mirëqenia sociale, qasja në të drejtën e punësimit pa diskriminim, zyrtarizimi i martesave joformale, dhuna seksuale apo ajo gjinore.

### *Misioni:*

PDC/K ofron pa pagesë ndihmë juridike dhe këshillime që kanë të bëjnë me çështjet gjinore dhe moshën për të kthyerit që janë pjesëtarë të pakicave, për

refugjatë dhe persona të zhvendosur brenda vendit (PZhB) dhe për banorët e cenusshëm vendor duke pasur për qëllim mbështetjen e kthimit të qëndrueshëm dhe kontributin për parandalimin e zhvendosjes së mëtejshme. Ndihma ofrohet pavarësisht nga raca, feja, kombësia dhe bindja politike e individit.

---

## **Zyra Ndërlidhëse e Gjykatës**

Kralja Petra BB, Mitrovicë  
+381 28 421 774, +377 44 425 649

### ***Shërbimet:***

Zyrat Ndërlidhëse të Gjykatës ju ofrojnë komuniteteve shërbime siç janë transporti për palët të cilat marrin pjesë në procedura gjyqësore; ndihma në paraqitjen e ankesave civile dhe penale; ndihma në gjetjen e ankesave të vjetra në arkivat e gjykatës; informatat juridike për çështjet që kanë të bëjnë me refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit; lehtësimi për vërtetimin e kontratave; referimi dhe ndërlidhja me organizatat joqeveritare; dhe mbështetja e përgjithshme gjatë procesit gjyqësor.

### ***Misioni:***

ZNGj i ndihmon komunitetet të cilat janë pakica etnike në Kosovë të kenë qasje në drejtësi.

---